



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.14-030/03-24534/24

Dt.14.02.2024

Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5, paragrafi c të Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nenit 80 paragrafi 1, dhe neni 81 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komuna e Prishtinës shpallë:

**KONKURS
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS**

Nr.	Niveli	Titulli i vendit të punës	Vend i lirë / Zëvendësim	Numri i pozitive
1	SHFMU	Mësimdhënës/e për Gjuhë gjermane	Vend i lirë	3
2	SHFMU	Mësimdhënës/e për Gjuhë gjermane	Zëvendësim	2

I. Aplikacionit i bashkëngjiten dokumentet, si vijon:

- Formulari i aplikimit (merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në KK Prishtinë);
- CD- Të gjitha dokumentet të skanohen dhe të vendosen në CD, e cila do të ruhet në arkivim dhe nuk do të kthehet prapa;
- Dokumenti personal kopje (letërnjoftim ose pasaportë);
- Rezymeja personale (CV);
- Diplomat e kualifikimit të noterizuara;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës së punës në institucionet edukative arsimore (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit arsimor

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it (UA Nr. 05/2021) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjuhë gjermane në shkollë fillore të mesme të ulët:**
 - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
 - Sistemi katërvjeçar;
 - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS).

Vërejtje: Udhëzimi Administrativ nr. 05-2021 për normativin mbi kuadrin profesional të Arsimit të përgjithshëm përcakton se “Të gjitha nivelet e përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ, duhet të jenë të profilit arsimor, duke përfshirë edhe programet arsimore të njësive akademike sipas nenit 6 dhe 7 të UA-së. Të gjithë të kualifikuarit në njësitë akademike që kanë përfunduar master arsimor 300 ECTS, sistemi katërvjeçar (profesor), baçelor katërvjeçar 240 ECTS kanë të drejtë të barabartë konkurrimi në arsimin parauniversitar të paraparë në nenin 6 dhe 7 të këtij Udhëzimi Administrativ”.

III. Detyrat dhe përgjegjësitë e mësimdhënësit

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj/ të punës;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri;
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi, barazi dhe pa dallime me bashkëpunëtorët të cilët punon;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t’i kryejë detyrat që mund t’ua caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Të mos kërkojë apo të pranojë udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç drejtorit të shkollës dhe DKA-së;
- Të mos e shfrytëzoi pozitën e punës për interesa private në dobi të ndonjë pale të tretë, përfshirë edhe familjen, shoqërinë apo miqësinë e tij.
- Të ushtrojë maturi maksimale lidhur me të gjitha çështjet e punës. Përfshirë, ruajtjen e informatave (nëse nuk janë publike), të cilat lidhën me procesin e punës dhe raporteve të krijuara prej saj, duke mos komunikuar këto informata me asnjë person fizik dhe juridik, përveç kur informatat e tilla janë të parapara në kuadër të detyrave apo autorizimit nga zyrtari të cilit i raporton.
- Të mbaj orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore.
- I punësuari është i obliguar të respektojë kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar me rregulloren e brendshme të shkollës dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore.
- I punësuari nuk do të kryejë punë apo detyrë tjetër, me orar të plotë, nëse puna e tillë, bie ndesh me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga DKA-ja ose përfaqësuesit të saj.
- Puna do të monitorohet dhe të vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve, sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës;
- Punë dhe detyra të tjera shtesë të caktuara nga drejtori i shkollës dhe detyra të përcaktuara në legjislacionin në fuqi të arsimit parauniversitar.

IV. Afati dhe mënyra e aplikimit

- **Konkursi mbetet i hapur 30 ditë nga data e publikimit të konkursit më 14.02.2024 deri më datën 13.03.2024.**
- Formulari i aplikimit merret në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në sportelin nr. 5, në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës;
- Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e vjetër të Komunës të Prishtinës përmes protokollit në Qendrën për Shërbim me Qytetarë;



- Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen dhe duhet të jenë kopje, përveç diplomave të noterizuara;
- Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë **diplomat e nostrifikuara në MASHTI**;
- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Nëse aplikohet për dy pozita (Vend i lirë/Zëvendësim), kandidatët duhet të dorëzojnë dy aplikacione të veçanta;
- Kandidatët duhet të ruajnë dëshminë e aplikimit (numrin e protokollit), e cila është e domosdoshme me rastin e shpalljes së rezultateve përkatëse;

V. Vlerësimi i kandidatëve

- Me këtë konkurs do të zhvillohen procedurat e rekrutimit të stafit arsimor për vitin shkollor 2024/2025.
- Kandidatët me kualifikime jo-përkatëse sipas ligjeve dhe UA të cekur në pikën II të këtij konkursi nuk do të merren në shqyrtim;
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kritereve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim;
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen deri në 50% të vlerësimit përfundimtar;
- Pikët e mbledhura në fazat vlerësuese renditin kandidatët me më shumë pikë që do të përzgjedhen në pozitat e lartpërmendura;
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test me shkrim dhe intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave publikohen në webfaqen e Komunes së Prishtinës <https://kk.rks-gov.net/prishtina/> <https://prishtinaonline.com/konkurset> dhe përmes e-mailit (bazuar në aplikacionin e kandidatit);
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në web-faqen zyrtare <https://kk.rks-gov.net/prishtina/> <https://prishtinaonline.com/konkurset>;
- Në rast të ndonjë nevoje eventuale për mësimdhënës/e në IEAA, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave të publikuara me rastin e shpalljes së rezultateve, e cila konsiderohet si listë pritëse;
- Anëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohen të aplikojnë në pozitat e shpallura në përputhje me kualifikimet përkatëse.

Vërejtje: Të gjitha aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.

